

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Ankesë kundër Autoritetit Kontraktues:

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr.: **328-25-10922-5-1-1**

Sa i përket tenderit për: **Ndërtimi i objektit të Gjykatës Themelore në Pejë**

A N K E S Ë

1. Identifikimi i ankuesit*

O.E.: PRO & CO GROUP SH.P.K

Në emër të GOE PRO & CO GROUP SH.P.K - EVEREST SHPK – BENI CONSTRUCTION SHPK

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

NUI: **811092254**

Numri fiskal: **600971916**

Rr. Llapnasellë, Marigona Residenc, p.n.

(Adresa)

GRAÇANICË

(Vendi)

10500

(Kodi postar)

+383 45 777 757

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

Kenan EMINI

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

procogroupshpk@gmail.com

(Adresa elektronike)

04.05.2026

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.



2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar "Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs të projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" apo "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ky aktivitet i prokurimit ka të bëjë me tenderin: Ndërtimi i objektit të Gjykatës Themelore në Pejë, Nr.: 328-25-10922-5-1-1.

Njoftimi për kontratë është publikuar më datë: 03.12.2025

Më datë: 03.03.2026 kemi dorëzuar të gjitha dokumentet e kërkuara në dosjen e tenderit.

Më datë 16.04.2026 AK ka publikuar njoftimin mbi vendimin (formulari B58) dhe në po të njëjtën datë kemi pranuar edhe Letrën standarde për tenderuesin e eliminuar, përmes të cilit jemi njoftuar se jemi shpallur të papërgjegjshëm dhe se aktiviteti i prokurimit është anuluar, për shkak të mungesës së ofertave të përgjegjshme.

Të pakënaqur me vendimin e AK, më datë 21.04.2026 iu kemi drejtuar të njëjtit me Kërkesë për rishqyrtim.

Më datë 22.04.2026 kemi pranuar vendimin e AK nr. 05/792, Nr. Ref. /D.P/64/2026, me të cilin kërkesa jonë për rishqyrtim është refuzuar si e pabazuar, ndaj dhe të pakënaqur me këtë vendim, brenda afatit ligjor, po i drejtohem OSHP me ankesë.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

Jo

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit? A keni bërë ndonjë reagim me shkrim dhe/ose kërkuar sqarime shtesë nga AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj, si dhe a u është përgjigjur me shkrim AK në lidhje me këtë? Nëse po, ofroni shkurtimisht detaje mbi këtë fakt:

Po

Jo

Më datë 16.04.2026 AK ka publikuar njoftimin mbi vendimin (formulari B58) dhe në po të njëjtën datë kemi pranuar edhe Letrën standarde për tenderuesin e eliminuar, përmes të cilit jemi njoftuar se jemi shpallur të papërgjegjshëm dhe se aktiviteti i prokurimit është anuluar, për shkak të mungesës së ofertave të përgjegjshme.

Të pakënaqur me vendimin e AK, më datë 21.04.2026 iu kemi drejtuar të njëjtit me Kërkesë për rishqyrtim.

Më datë 22.04.2026 kemi pranuar vendimin e AK nr. 05/792, Nr. Ref. /D.P/64/2026, me të cilin kërkesa jonë për rishqyrtim është refuzuar si e pabazuar, ndaj dhe të pakënaqur me këtë vendim, brenda afatit ligjor, po i drejtohem OSHP me ankesë.

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Në kuadër të këtij aktiviteti të prokurimit publik, me rastin e ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve të dorëzuar, si dhe me nxjerrjen e vendimeve të theksuara më lart, AK ka shkelur dispozitat e mëposhtme të LPP:

Neni 59 LPP – Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

Neni 61 LPP – Tenderët jo-normalisht të ulët

Neni 65 LPP – Pranueshmëria e Kandidatëve ose Tenderuesve

Nenet 41 dhe 43 të RRPP

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Pretendimi nr. 1: - Pozicionet 1.2, 1.5, 1.6, 2.1, 3.2 të listës së çmimeve:

Parashtrojmë se konstatimet e AK për kinse papërgjegjshmëri administrative të ofertës tonë lidhur me pozicionet nga pikat 1.2, 1.5, 1.6, 2.1, 3.2 të listës së çmimeve – ofertës së dorëzuar, bien në kundërshtim me nenin 4, pika c) e RRPP, për shkak se krahasimi nga këto pika nuk është bërë në raport me çmimet e tregut për ato pozicione, por në raport me ofertat e operatorëve të tjerë të cilët janë konsideruar si të papërgjegjshëm nga vetë AK dhe si të tillë janë eliminuar nga ky aktivitet i prokurimit.

Lidhur me pretendimin në fjalë, në letrën standarde për tenderuesin e eliminuar, dt. 16.04.2026, AK konstaton se:

Tenderi juaj është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të dhëna në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Me keqardhje ju njoftojmë se jeni eliminuar për shkak të arsyeve në vijim:
Tenderi i juaj është administrativisht i papërgjegjshëm:

ARSYETIM

Ju jeni diskualifikuar për këto arsye :

Komisioni i vlerësimit pas identifikimit të çmimeve jo-normalisht të ulët (jashtëzakonisht të ulëta dhe të larta), Autoriteti Kontraktues me date e 10.04.2026 ju ka kërkuar sqarime të detajuara dhe dëshmi për secilin çmim të kontestuar deri me date 15.04.2026, ora 16:00

Megjithatë, nga ana juaj është dorëzuar vetëm një deklaratë e përgjithshme me date 15.04.2026, pa ofruar sqarime konkrete dhe pa dëshmi mbështetëse për çmimet e kërkuara, për artikuljt e veçuar ashtu siç është kërkuar në kërkesën për sqarim në letrën standarde të datës të lart cekuar

Si rrjedhojë, konsiderohet se nuk keni arritur të arsyetoni çmimet e ofruara në ofertën e dorëzuar me date 15.01.2025 .

Në përputhje me LPP dhe RR. Për PP, oferta juaj është e papërgjegjshme.

Po ashtu, në vendimin nr. 05/792, Nr. Ref. /D.P/64/2026, dt. 22.04.2026, AK konstaton se:

Përgjigje ndaj pretendimit nr. 1

Komisioni i Vlerësimit, në përbërje të plotë prej tre (3) anëtarësh, pas analizës së ofertave të pranuar, ka identifikuar në ofertën tuaj çmime jo-normalisht të ulëta (përfshirë çmime jashtëzakonisht të ulëta dhe të larta) në Listën e Çmimeve.

Në përputhje me legjislacionin në fuqi për prokurimin publik, konkretisht:

1. Ligjin për Prokurimin Publik (LPP), neni 61;
2. Rregulloren Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, të ndryshuar dhe plotësuar, Udhëzuesin Nr. 002/2024 dhe Udhëzuesin Nr. 001/2023 për Prokurimin Publik, neni 4 pika (C), i cili përcakton se çmimi i kontraktuar nuk duhet të jetë më i lartë se çmimi i tregut dhe nenin 41 që trajton tenderët jo-normalisht të ulët,

Komisioni i vlerësimit nga Autoriteti Kontraktues – SKGJK, me Letër Standarde e kërkesës për informata mbi tenderët jo-normalisht të ulët e datës 10.04.2026, ju ka kërkuar sqarime të detajuara dhe dëshmi mbështetëse për secilin çmim të kontestuar, duke përcaktuar afatin ligjor për dorëzim deri më datë 15.04.2026, ora 16:00.

Me datë 15.04.2026, ju keni ngarkuar në platformën e prokurimit vetëm një deklaratë të përgjithshme, pa ofruar sqarime konkrete dhe pa paraqitur dëshmi relevante mbështetëse për çmimet e kontestuara, sipas kërkesave të përcaktuara në shkresën për sqarim "Letër Standarde e kërkesës për informata mbi tenderët jo-normalisht të ulët" të datës 10.04.2026.

Komisioni i Vlerësimit konstaton se Grupi i Operatorëve Ekonomikë: Pro & Co Group SH.P.K., EVEREST SH.P.K. dhe Beni Construction SH.P.K., nuk ka arritur të arsyetojë asnjë nga çmimet e paraqitura në ofertë, përkatësisht në Listën e Çmimeve të dorëzuar.

Në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, oferta juaj konsiderohet e paarsyetuar lidhur me çmimet e paraqitura, të cilat vlerësohen si çmime manipulative në ofertën e dorëzuar nga GOE: Pro & Co Group SH.P.K., EVEREST SH.P.K. dhe Beni Construction SH.P.K.

Kërkesa juaj për rishqyrtim refuzohet si E PABAZUAR

Konstatimet e mësipërme të AK për kinse papërgjegjshmëri administrative të ofertës tonë lidhur me pozicionet nga pikat 1.2, 1.5, 1.6, 2.1, 3.2 të listës së çmimeve – ofertës së dorëzuar, bien në kundërshtim me nenin 4, pika c) e RRPP, për shkak se **krahasimi nga këto pika nuk është bërë në raport me çmimet e tregut për ato pozicione, por në raport me ofertat e operatorëve të tjerë të cilët janë konsideruar si të papërgjegjshëm nga vetë AK dhe si të tillë janë eliminuar nga ky aktivitet i prokurimit.**

Pretendimi nr. 2: - Pozicionet 6.1, 7.1, 8.5, 11.1, 11.6, 12.1, 12.2, 16.3, 16.18, 1.1.20, 5.1.1 dhe 5.1.3 të listës së çmimeve:

Parashtrojmë se konstatimet e AK për kinse papërgjegjshmëri administrative të ofertës tonë lidhur me pozicionet nga pikat 6.1, 7.1, 8.5, 11.1, 11.6, 12.1, 12.2, 16.3, 16.18, 1.1.20, 5.1.1 dhe 5.1.3 të listës së çmimeve – ofertës së dorëzuar bien në kundërshtim me nenin 61 të LPP dhe nenin 41 të RRPP, për arsytet vijuese.

Lidhur me pretendimin në fjalë, në letrën standarde për tenderuesin e eliminuar, dt. 16.04.2026, AK konstaton se:

Tenderi juaj është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të dhëna në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Me keqardhje ju njoftojmë se jeni eliminuar për shkak të arsyeve në vijim:
Tenderi i juaj është administrativisht i papërgjegjshëm:

ARSYETIM

Ju jeni diskualifikuar për këto arsye :

Komisioni i vlerësimit pas identifikimit të çmimeve jo-normalisht të ulët (jashtëzakonisht të ulëta dhe të larta), Autoriteti Kontraktues me date 10.04.2026 ju ka kërkuar sqarime të detajuara dhe dëshmi për secilin çmim të kontestuar deri me date 15.04.2026, ora 16:00

Megjithatë, nga ana juaj është dorëzuar vetëm një deklaratë e përgjithshme me date 15.04.2026, pa ofruar sqarime konkrete dhe pa dëshmi mbështetëse për çmimet e kërkuara, për artikujt e veçuar ashtu siç është kërkuar në kërkesën për sqarim në letrën standarde të datës të lart cekuar

Si rrjedhojë, konsiderohet se nuk keni arritur të arsyetoni çmimet e ofruara në ofertën e dozuara me date 15.01.2025 .

Në përputhje me LPP dhe RR. Për PP, oferta juaj është e papërgjegjshme.

Po ashtu, në vendimin nr. 05/792, Nr. Ref. /D.P/64/2026, dt. 22.04.2026, vërehet qartazi se AK nuk adreson fare një pretendim të tillë, të artikuluar në Kërkesën për rishqyrtim.

Lidhur me këtë pikë, parashtrojmë se krahasimet janë bërë në kundërshtim me nenin 41.3 të RRPP, përkatësisht janë bërë në raport me ofertat e operatorëve të tjerë të cilët janë konsideruar si të papërgjegjshëm nga vetë AK dhe si të tillë janë eliminuar nga ky aktivitet i prokurimit.

Për më tepër, AK ka dështuar që të marrë në konsideratë shpjegimet e GOE, të dhëna në deklaratën sqaruese të datës 15.04.2026, në raport me kushtet imperative nga neni 61.2 i LPP dhe neni 41.8 i RRPP, përkatësisht në raport me:

- ekonominë e procesit të prodhimitarisë, të shërbimeve të ofruara dhe/ose të metodave të ndërtimit;
- çfarëdo zgjidhje teknike që janë ofruar ose zgjedhur;
- çfarëdo kushte veçanërisht të favorshme që janë në dispozicion për tenderuesin për furnizimin e produkteve, sigurimin e shërbimeve, ekzekutimin e projekteve të punëve dhe/ose ushtrimin e aktiviteteve të ndërtimit që janë duke u prokuruar; dhe/ose
- origjinalitetin e furnizimeve, shërbimeve, punës dhe punëve të propozuara;
- elementet e tenderit përfshirë elementet e nën-totaleve për paga si dhe kompensimet, materialet, kostot fikse dhe profitet.

Deklaratë sqaruese

GOE: Pro & Co Group SH.P.K.; EVEREST SH.P.K.; Beni Construction SH.P.K.
Titulli i aktivitetit të prokurimit: "Ndërtimi i objektit të Gjykatës Themelore në Pejë"
Nr. i Prokurimit: 328-25-10922-5-1-1
Nr. i Brendshëm: 33300/25/034/511

U nderuar Autoritet Kontraktues,

Në përgjigje të kërkesës suaj të adresuar përmes *Letër Standarde me kërkesën për Informatat*, lidhur me sqarimin e disa çmimeve të ofruara të cilat janë cilësuar si jo-normalisht të ulëta, ju paraqesim sqarimin tonë teknik, ekonomik dhe ligjor si në vijim.

Struktura e çmimeve në ofertën tonë është e balancuar në nivel total. Disa pozicione paraqiten me çmime më të larta për shkak të përfshirjes së plotë të kostove dhe përgjegjësive përkatëse, ndërsa disa të tjera janë më të ulëta si rezultat i avantazheve tona konkurruese, përfshirë kapacitetet e brendshme, furnizimin direkt dhe ekonominë e shkallës. Kjo qasje është praktikë e zakonshme dhe nuk përbën manipulim të çmimeve.

Krahasimi me ofertat tjera -Sa i përket krahasimit të bërë nga ana juaj, vërejmë se ai është realizuar në mënyrë lineare dhe selektive për pozicione individuale. Megjithatë, edhe ofertat e operatorëve të tjerë ekonomik përmbajnë çmime të ndryshme në pozicione të ndryshme dhe asnjë ofertë nuk është uniforme në tërësi. Për rrjedhojë, një krahasim i kufizuar në disa pozicione nuk përfaqëson një analizë të plotë dhe objektive.

Argumenti ligjor -Në aspektin ligjor, duke u bazuar në Nenin 61 të Ligjit për Prokurimin Publik, vlerësimi i ofertës duhet të bëhet në nivel të përgjithshëm, duke marrë në konsideratë realizueshmërinë e kontratës. Pozicionet individuale nuk mund të shërbejnë si bazë për diskualifikim, përderisa oferta në tërësi është e realizueshme, e balancuar dhe konkurruese. Çdo devijim nga ky standard përbën interpretim të gabuar të ligjit dhe cenon drejtpërdrejt parimet e barazisë në trajtim dhe transparencës.

Arsyetimi i pozicioneve -Çmimet e paraqitura nga ana jonë janë plotësisht të arsyetuara. Çmimet më të larta në disa pozicione janë rezultat i përfshirjes së elementeve si mobilizimi, pajisjet profesionale, staf teknik dhe rreziku operacional, ndërsa çmimet më të ulëta reflektojnë avantazhet tona konkurruese dhe organizimin efikas të burimeve. Këto janë elemente të ligjshme të konkurrencës dhe nuk mund të interpretohen si indikacion i ofertës jo-normalisht të ulët.

Pozicioni ynë në total- Nga analiza e përgjithshme rezulton se oferta jonë është ndër më konkurrueset dhe ekonomikisht më të favorshmet. Edhe në rastet kur disa pozicione janë më të larta, në total ajo mbetet e balancuar dhe në përputhje me interesin publik.

Kërkesë për sqarim mbi bazën e krahasimit- Me qëllim të transparencës, kërkojmë sqarim lidhur me metodologjinë e përdorur për vlerësimin e çmimeve, konkretisht nëse është përdorur ndonjë

çmim referues zyrtar, nëse ekziston analizë e dokumentuar e tregut, apo nëse krahasimi është bazuar vetëm në ofertat e operatorëve ekonomik.

Thesojmë se krahasimi i thjeshtë ndërmjet ofertuesve, pa një bazë objektive tregu, nuk përmbush standardin ligjor për vlerësim dhe nuk mund të prodhojë pasojë juridike ndaj operatorit ekonomik. Njëkohësisht, kërkojmë sqarim lidhur me natyrën e kontratës (kontratë me çmime për njësi apo me çmim total), pasi kjo çështje është thelbësore për mënyrën e interpretimit të strukturës së çmimeve dhe për vlerësimin e drejtë të ofertës.

Referencë ndaj praktikave të mëparshme (Auditimi)- Duke u bazuar në gjetjet e auditimit, janë evidentuar raste ku janë pranuar oferta me çmime simbolike në pozicione të caktuara, duke u vlerësuar oferta në tërësi dhe jo mbi bazë të pozicioneve individuale. Po ashtu, në raste të ngjashme janë konsideruar të pranueshme diferenca të konsiderueshme ndërmjet ofertave, përfshirë:

- deri në 10% më e ulët se oferta e dytë;
- deri në 30% më e ulët se mesatarja e ofertave;
- dhe ekzistenca e së paku tre ofertave valide si indikator i konkurrencës së tregut.

Prandaj, kërkojmë që i njëjti standard të zbatohet edhe në rastin tonë, duke siguruar trajtim të barabartë dhe konsistencë në vendimmarrje

Praktika e Organi Shqyrtues i Prokurimit - Duke iu referuar praktikës së OSHPs, konkretisht Vendimit nr. 717/25, në rastet që trajtojnë çështjen e ofertave me çmim jo-normalisht të ulët, është theksuar se vlerësimi duhet të bëhet në nivel të ofertës në tërësi dhe jo mbi bazë të pozicioneve individuale. Prandaj, kërkojmë që i njëjti standard të zbatohet edhe në rastin tonë, duke siguruar trajtim të barabartë dhe konsistencë në vendimmarrje.

Garancioni i ekzekutimit- Thesojmë se për këtë kontratë ne ofrojmë garancion të ekzekutimit, i cili mbulon në tërësi përmbushjen e obligimeve kontraktuale dhe garanton realizimin korrekt të punimeve. Ky garancion përbën siguri të mjaftueshme për Autoritetin Kontraktues dhe mbulon çdo rrezik eventual në ekzekutimin e kontratës..

Qëndrim për integritetin dhe paanshmërinë- Vlerësojmë se mënyra e vlerësimit në këtë rast nuk reflekton plotësisht një analizë objektive dhe të balancuar të ofertës sonë. Fokusimi selektiv në disa pozicione ngre shqetësime lidhur me paanshmërinë, trajtimin e barabartë dhe ndikimin e mundshëm të faktorëve jo-teknikë. Çdo devijim nga parimet e transparencës dhe barazisë mund të perceptohet si cenim i konkurrencës së drejtë.

Në si kompani me mbi 200 të punësuar, me kapacitete të dëshmuara, referenca të qëndrueshme dhe kontribut të vazhdueshëm në buxhetin e Republikës së Kosovës, presim që vlerësimi i ofertës sonë të bëhet në përputhje të plotë me ligjin dhe mbi baza objektive. Çdo vendimmarrje që bie ndesh me këto parime do të kundërshtohet përmes mjeteve juridike të parapara në legjislatcionin në fuqi.

Përfundim- Oferta jonë është në përputhje me Ligjin për Prokurimin Publik, është e realizueshme, konkurruese dhe në interes të buxhetit publik. Andaj, kërkojmë që vlerësimi të bëhet në nivel të ofertës në tërësi dhe në përputhje me standardet ligjore në fuqi.

Graçanicë,
Më: 15.04.2026



Kenan Emiri
Pro & Co Group Sh.P.K

Dështimi për të analizuar dhe vlerësuar siç duhet ofertën e GOE PRO & CO GROUP SH.P.K - EVEREST SHPK– BENI CONSTRUCTION SHPK, sipas nesh, ka rezultuar në shkeljen e neneve 59, 61 dhe 65 të LPP, si dhe të neneve 41 dhe 43 të RRPP, çka për bindjen tonë kushtëzon kthimin në rivlerësim të këtij aktiviteti të prokurimit.

Bazuar në argumentet e artikuluar detajisht më lart, apelojmë që paneli shqyrtues pranë OSHP, pas analizës dhe shqyrtimit të të gjitha pretendimeve ankimore me vëmendje dhe përkushtim maksimal profesional, të marrë këtë:

V E N D I M

APROVOHET NË TËRËSI si e bazuar ankesa e OE PRO&CO GROUP SHPK lidhur me tenderin

**Ndërtimi i objektit të Gjykatës Themelore në Pejë
me nr.prokurimi: 328-25-10922-5-1-1**

inicuar dhe administruar nga AK-KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS;

ANULOHET vendimi i AK – Këshilli Gjyqësor i Kosovës, nr. 05/792, Nr. Ref. /D.P/64/2026, dt. 22.04.2026 mbi refuzimin e Kërkesës për rishqyrtim dt. 21.04.2026;

ANULOHET njoftimi mbi vendimin e AK – Këshilli Gjyqësor i Kosovës, dt. 16.04.2026;

**KTHEHET NË RIVLERËSIM lënda lidhur me aktivitetin e prokurimit
Ndërtimi i objektit të Gjykatës Themelore në Pejë
me nr.prokurimi: 328-25-10922-5-1-1**

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës:

Shkeljet e artikuluar detajisht në këtë ankesë i shkaktojnë dëme të konsiderueshme financiare GOE PRO & CO GROUP SH.P.K - EVEREST SHPK– BENI CONSTRUCTION SHPK, për shkak se i njëjti, **duke qenë i vetmi ofertues i përgjegjshëm me çmimin më të lirë** për aktivitetin lëndor të prokurimit privohet nga përfitimet monetare të ligjshme që derivojnë nga implementimi i kontratës përkatëse.

Njëkohësisht, GOE PRO & CO GROUP SH.P.K - EVEREST SHPK– BENI CONSTRUCTION SHPK, si pasojë e shkeljeve të theksuara më lart, privohet gjithashtu nga:

- e drejta për t'iu nënshtruar një procedure të prokurimit publik të ligjshme, të drejtë, transparente dhe pa diskriminim ndaj të gjithë operatorëve ekonomikë në procesin e përzgjedhjes për realizimin e aktivitetit lëndor të prokurimit;
- e drejta për t'u kualifikuar si operator i përgjegjshëm me çmimin më të ulët për aktivitetin lëndor të prokurimit;
- mundësia e fitimit të përvojës profesionale në zhvillimin e aktivitetit të tij të rregullt afarist, në një ambient ekonomik të besueshëm ku funksionon rendi publik dhe sundimi i ligjit.

9. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkëngjitura:

Kësaj ankese i bashkëngjiten në shtojcë:

- Njoftimi për kontratë dt. 03.12.2025
- Njoftimi mbi vendimin e autoritetit kontraktues, dt. 16.04.2026;
- Kërkesa për rishqyrtim dt. 21.04.2026;
- Vendimi mbi refuzimin e Kërkesës për rishqyrtim, nr. 05/792, Nr. Ref. /D.P/64/2026, dt. 22.04.2026.